

# Llojet e testeve ofrohen në pikat e testimit të shpejtë të H+H

Pikat e testimit mund t'i ofrojnë të gjitha ose një pjesë nga llojet e mëposhtme të testeve:

	Testi PCR administrohet nga infermierja	Testi PCR me vetadministrim	Molekular i shpejtë Abbott ID NOW	Antigjen i shpejtë Abbott BinaxNOW
<b>Çfarë lloj testi është?</b>	Ky është test diagnostikues. Tregon nëse keni infektion aktiv me koronavirus.	Ky është test diagnostikues. Tregon nëse keni infektion aktiv me koronavirus.	Abbott ID NOW është një test i shpejtë, molekular, në pikën e shërbimit. Tregon nëse keni infektion aktiv me koronavirus.  Nëse merrni test të shpejtë me Test & Trace, ne ju kryejmë <b>edhe</b> një test PCR*.	Abbott BinaxNOW është një test i shpejtë me antigjen. Tregon nëse keni infektion aktiv me koronavirus.  Nëse merrni test të shpejtë me Test & Trace, ne ju kryejmë <b>edhe</b> një test PCR*.
<b>Kush e merr mostrën?</b>	Këtë e bëni ju vetë ose një infermiere.	Këtë e bëni ju vetë.	Këtë e bën një infermiere.	Këtë e bën një infermiere.
<b>Kur do t'i marr rezultatet?</b>	Zakonisht brenda 2 ditëve.	Zakonisht brenda 2 ditëve.	Zakonisht brenda 15-30 minutave.	Zakonisht brenda 15-30 minutave.
<b>Si do t'i marr rezultatet?</b>	Rezultatet ofrohen nga MyChart. Nëse nuk keni llogari në MyChart, do të merrni një telefonatë apo email.	Rezultatet do t'ju dërgohen në adresën e emailit.	Do t'ju duhet të prisni në vend dhe personeli mjekësor do t'ju japë rezultatet. Rezultatet ofrohen edhe përmes MyChart.	Do t'ju duhet të prisni në vend dhe personeli mjekësor do t'ju japë rezultatet. Rezultatet ofrohen edhe përmes MyChart.

**Të gjitha testet janë tamponë hunde**, që është një tampon pambuku apo sfungjeri që ju futet në hundë.

Merreni kartën e sigurimeve me vete nëse keni sigurim shëndetësor. Nëse nuk keni sigurim, mund të testoheni gjithsesi.

[Nuk ka nevojë të paguani për testin.](#) Nëse keni sigurim, do t'ju faturojmë llogarinë e sigurimit, por kjo do të jetë pa kosto aktuale.

**Nuk do t'ju pyesim për statusin tuaj të imigrimit.**

**I gjithë testimi është procedurë me paraqitje në vend; nuk ka nevojë për takime.**

\*Reaksion zinxhir polimeraze

Nga data 24 nëntor 2020

**NYC**  
**HEALTH+**  
**HOSPITALS**

**Test & Trace**  
**Corps**